

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-058/14

Prishtinë, 4 Dhjetor 2014

**Në çështjen juridike të:**

D.D.

Podgoricë

***Pala ankuese***

Kundër

***Nuk dihet***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esmë Ertezi dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/204/2013 të datës 11 qershor 2013 (lënda e regjistruar në AKP me nr. KPA 17908), pas seancës gjyqësore, të mbajtur më 4 Dhjetor 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Hidhet poshtë si e pa-afatshme ankesa e D. D. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/204/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 17908) të datës 11 qershor 2013.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 30 janar 2007, D.D. paraqitësi i kërkesës, (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) në cilësinë e tij si një anëtar i familjes së të ndjerit ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave nr. 137, 138 dhe 140 të cilat gjenden në vendin e quajtur Piskoti, në zonën kadastrale Jahoc, Komuna e Gjakovës. Kërkesa është regjistruar në AKP nën numrin KPA17908.
2. Pala ankuese ka dorëzuar në AKP dokumentet e mëposhtme për të mbështetur kërkesën e tij:
  - Padinë në Gjykatën Komunale të Gjakovës për kthimin e posedimit mbi tokën, të parashtruar më 26 dhjetor 1995 nga D. D.;
  - Certifikatën nr. 01-951-1-152 / 1993 të lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë Komunale të Gjakovës më 4 maj 1993, lidhur me historiatin e ngastrave të kërkuara;
  - Një kopje të letërnjoftimit të D. D.;
  - Ankesën kundër vendimit P.nr.3108 / 04 e datës 30 maj 2008 të Gjykatës Komunale të Pejës ku pala ankuese e ka kundërshtuar vendimin gjyqësor P.nr.3108 / 04 të datës 9 mars 2007 përmes të cilit Gjykata në fjalë shpalli veten jokompetente për të vendosur lidhur me pronën e pretenduar dhe udhëzoi paraqitësin e kërkesës që të adresojë çështjen e tij pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës;
  - Vendimin nr. 487 i datës 7 shkurt 1946 i lëshuar nga Komisioni Rishikues Agrar për Kosovën mbi ndarjen e tokës;
3. AKP-ja e ka verifikuar dokumentin e dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës. Nga verifikimi rezultoi se parcelat e kërkuara 137, 138 dhe 140 bazuar në aero-incizimin e vitit 1982, në vitin 1988 iu janë nënshtruar komasacionit pastaj këto ngastra iu bashkuan ngastrave të tjera të tokës dhe morën një

numër të ri të ngastrës nr.46, e cila ishte shënuar në fletën poseduese nr. 772 në emër të PIK "Ereniku" Gjakovë. Sekretaria Ekzekutive e ka gjetur sipas detyrës zyrtare fletën poseduese nr. 772, të datës 16.12.2008 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Komuna e Gjakovës, e cila e shënon pronën e kërkuar në emër të PIK "Ereniku" (ndërmarrje në pronësi shoqërore), Gjakovë.

4. Kur u kontaktua nga Sekretariati Ekzekutiv, pala ankuese deklaroi se në vitin 1995 ai kishte iniciuar procedurat gjyqësore në Gjykatën Komunale të Gjakovës për kthimin e pronës së kërkuar. Në deklaratën e tij më 20 tetor 2010, ai deklaroi se gjyshi i tij e kishte humbur pronën në vitin 1946 nga shpronësimi.

5. Njoftim i pronës është bërë më 28 dhjetor 2010 nëpërmjet publikimit në Gazetën e Publikimeve të AKP-së nr. 2.

6. Kërkesa është e pakontestueshme gjatë procedurës në shkallë të parë për shkak se asnjë palë përgjegjëse në kërkesë nuk ishte paraqitur në AKP-së për të kërkuar të drejtën mbi pronën.

7. KKPK-ja hodhi poshtë kërkesën me vendimin KPPC/D /A /204/2013 të datës 11 qershor 2013 me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë se kërkesa ka të bëjë me rrethanat që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999. Prandaj, kërkesa bie jashtë mandatit të KKPK-së.

8. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 7 nëntor 2013.

9. Më 20 dhjetor 2013, ai paraqiti ankesë kundër vendimit në fjalë të KKPK-së. Së bashku me ankesën, pala ankuese ka paraqitur edhe dokumentet (kopjet) e mëposhtme si prova:

- Padinë kundër PIK Erenik në Gjakovë, për kthimin e posedimit mbi tokën, të paraqitur në Gjykatën Komunale të Gjakovës më 26 dhjetor 1995;
- Certifikatën mbi historiatin e ngastrave të kërkuara të lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë Komunal të Gjakovës më 4 maj 1993;
- Vendimin nr.487 të datës 7 shkurt 1946 e lëshuar nga Komisioni Rishikues Agrar për Kosovën mbi ndarjen e tokës.

### **Pretendimet e palës ankuese:**

10. Pala ankuese me ankesën e tij e pranon se kërkesa e tij për kthimin e posedimit mbi pronën nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998-1999, por ajo bazohet në uzurpimin e pronës në vitin 1995. Ai deklaron se prona ishte uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga PIK Erenik

Gjakovë dhe kërkon nga Gjykata Supreme të pranojë ankesën e tij dhe të marrë një vendim për kthimin e posedimit mbi pronën të tij.

**Arsyetimi ligjor:**

*Pranueshmëria e ankesës:*

11. Ankesa është e papranueshme për shkak se nuk është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë me nenin 12.1 të Ligjit Nr 03 / L-079. Atij iu është dorëzuar vendimi më 7 nëntor 2013. Afati për parashtrimin e ankesës kishte skaduar qysh më 7 dhjetor 2013, ndërsa ankesa është parashtruar më 20 dhjetor 2013. Gjykata Supreme tanimë ka vendosur në raste të ngjashme siç është GSK-KPA- A-29-33/12, ku ankesa ishte paraqitur 13 ditë pas afatit. Prandaj ankesa duhet të hedhet poshtë si e pa-afatshme. Vendimi i ankimuar i KPPK-së që është çështje lëndore e ankesës në lidhje me kërkesën KPA17908 merr formën e prerë.

12. Nga sa u tha më lart, në pajtim me nenin 196 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

13. Ky aktgjykim nuk përjashton dhe kufizon të drejtën e paraqitësi të kërkesës për t'i kërkuar të drejtat e tij pronësore, nëse ka ndonjë, në gjykatat kompetente.

**Këshillë ligjore:**

14. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX**

**Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it**